



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Fundjavën e kaluar, më 2 shtator, Zyra Administrative mundësoi vizitën si i paraburgosur të z. Hashim Thaçi në Kosovë për t'u takuar me anëtarë të familjes, për arsye bindëse humanitare, sipas udhëzimeve të Trupit Gjykses. Gjatë vizitës, i akuzuari vazhdoi të mbahej në paraburgim dhe nën ruajtje të Dhomave të Specializuara, ndërsa EULEX-i dhe policia e Kosovës mbështetën Dhomat e Specializuara të Kosovës.

Në gjykimin e *Hashim Thaçit dhe të bashkakuzuarve*, këtë javë dhanë dëshmi tre dëshmitarë. Dëshmitari i 20-të i thirrur nga Prokuroria dha dëshmi të hënën me masa mbrojtëse, përfshirë ndryshim të zërit dhe fytyrës, lidhur me rrëmbimin e pretenduar të anëtarit të familjes së dëshmitarit nga anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në 1998 dhe zhdukjen e anëtarit të familjes.

Dëshmitari i 21-të i thirrur nga Prokuroria në këtë çështje gjyqësore, Agim Idrizi, dha dëshmi në seancë të hapur të hënën dhe të martën, lidhur me rrëmbimin, ndalimin dhe keqtrajtimin e pretenduar të tij nga anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në 1999. Dëshmitari dha dëshmi pa masa mbrojtëse.

Të enjten, dëshmitari i 22-të i thirrur nga Prokuroria, Frederik Abrahams nga OJQ-ja ndërkombëtare *Human Rights Watch* filloi dhënien e dëshmisë lidhur me punën e organizatës së tij në Kosovë gjatë periudhës së aktakuzës. Dëshmia vazhdoi të mërkurën dhe të enjten.

Krahas marrjes në pyetje nga Prokuroria, dëshmitarët u morën në pyetje edhe nga ekipet e Mbrojtjes. Atyre iu bënë pyetje edhe Mbrojtësi i Viktimave dhe Gjykatësit.

Seanca e radhës në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* është planifikuar për të hënën e ardhshme, 11 shtator, në orën 9:00 paradite.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, të enjten e kaluar, 31 gusht, Trupi Gjykses urdhëroi që pjesë të transkriptit të seancave private të mbajtura më 30-31 maj, 2 dhe 6 qershor dhe 3 korrik 2023 të riklasifikohen si publike, së bashku me redaktimet e nevojshme.

Ky vendim u mor në përputhje me vendimin e Trupit Gjykses në maj, me të cilin Prokuroria, Mbrojtja dhe Mbrojtësi i Viktimave u urdhëruan t'i rishikonin transkriptet në vijimësi pas përfundimit të çdo blloku dëshmish, si dhe të bënin parashtrime.. Qëllimi i këtyre masave është respektimi i parimit të procesit publik, duke respektuar në të njëjtën kohë edhe masat mbrojtëse të domosdoshme për dëshmitarët dhe viktimat.

Pyetje nga gazetarët Nuk pati pyetje

